



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FEDERATA SHQIPTARE E KARATESË**



RREGULLORE E KOMISIONIT TEKNIK

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Karatesë

Datë 12 Shkurt 2017

Federata Shqiptare e Karatesë, me qëllim rritjen e shkallës së mirëfunksionimit dhe efektivitetit të veprimtarisë së saj, në përputhje me rregullat dhe parimet e Federatës Botërore të Karatesë (këtu e në vijim “**WKF**”), bazuar në Ligjin Nr. 9376 datë 21.04.2005 “*Për Sportin*” i ndryshuar, dhe në Statutin e saj, miratuar me Urdhër Nr. 54, datë 25.02.2014 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit,

V E N D O S I:

Neni 1. Qëllimi

Kjo Rregullore e Komisionit Teknik (këtu e në vijim “**Rregullorja**”) synon rregullimin e veprimtarisë së Komisionit Teknik (këtu e në vijim “**Komisioni**”) të Federatës Shqiptare të Karatesë (këtu e në vijim “**FSHK**”).

Neni 2. Fusha e Zbatimit

Kjo Rregullore është e zbatueshme për të gjithë anëtarët e Komisionit, gjatë gjithë veprimtarisë së tyre, si dhe të gjithë anëtarët e FSHK-së dhe personat e tjerë të pëfshirë në veprimtaritë sportive të karatesë, për aq sa kjo Rregullore është e zbatueshme.

Neni 3. Komisioni Teknik

3.1 Veprimtaria e Komisionit Teknik i shërben realizimit të nivelit më të lartë të mundshëm të sportit të karatesë dhe nxitjes së unifikimit të standardeve të FSHK-së me standardet e Federatës Botërore të Karatesë, Federatës Europiane të Karatesë dhe institucioneve të tjera ndërkombëtare, në kuadër të strategjisë kombëtare të sportit në Republikën e Shqipërisë.

3.2 Funksionet, detyrat dhe procedurat e Komisionit bazohen në traditën, vlerat, praktikat dhe origjinën e teknikave të stileve të karatesë.

3.3 Komisioni është organ këshillimor për çështjet teknike, për rritjen e cilësisë së sportit të Karatesë dhe përgjegjës për mbikqyrjen e aktiviteteteve teknike të kryera nën kujdesin e FSHK.

3.4 Komisioni mbledhet të paktën 4 (katër) herë në vit. Mbledhjet njoftohen nga Sekretari i Komisionit, nëse ka, me urdhër të Kryetarit të Komisionit bashkëngjitur me pikat e rendit për diskutim. Kuorumi për mbledhjet do të jetë të paktën 3 (tre) anëtarë, njëri prej tyre, Kryetari. Vendimet e Komisionit do të miratohen me shumicë të thjeshtë. Në rast barazimi Kryetari ka fuqinë e një vote të dytë.

3.5 Komisioni rezervon të drejtën për të emëruar dhe larguar çdo anëtar, përveç kryetarit, me vendim të shumicës së anëtarëve të tij në detyrë. Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë t’i propozojnë Komitetit Drejtues shkarkimin e kryetarit të Komisionit Teknik sipas një kërkesë të motivuar me shkrim.

3.6 Anëtarët e Komisionit e humbin statusin e tyre në rastet si vijon:

- a) Vetëdorëheqje;
- b) Mospjesëmarrje në 3 mbledhje radhazi;
- c) Rikompozim i Komisionit nga Komiteti Drejtues.

3.7 Në mënyrë të posaçme, Komisioni ngarkohet me kompetencat si vijon:

- a) Të kryejë hulumtime dhe studime për zhvillim të metodave dhe teknikave të trajnimit (stërvitjes) të Artit të Karatesë;
- b) Të vendosë standarde për titujt Kyu and Dan për anëtarët e FSHK-së;
- c) Të ndihmojë në promovimin e aktiviteteve të FSHK-së dhe WKF-së;
- d) Të përcaktojë programin teknik të zhvillimit të aktiviteteve kombëtare, duke u bazuar në Rregulloren Ndërkombëtare për moshat dhe peshat që do të marrin pjesë në këto veprimtari;
- e) T'i propozojë Komitetit Drejtues modifikimin e rregullores së garave dhe rregulloreve teknike të sportit të Karatesë sipas ndryshimeve që ndodhin dhe në Rregulloren Ndërkombëtare të WKF-së;
- f) Të planifikojë/përpilojë në bashkëpunim me Komitetin Drejtues kalendarin vjetor të aktiviteteve kombëtare duke u bazuar në kalendarin e aktiviteteve ndërkombëtare të WKF-së, EKF-së, KFB-së etj;
- g) Të mbikqyrë dhe ndjekë veprimtarinë e sportistëve më të talentuar të Karatesë, të cilët gëzojnë përkrahjen e Komitetit Drejtues të FSHK-së dhe të ndihmojë në ngritjen profesionale të tyre;
- h) Të përcaktojë listën e sportistëve më të mirë të vitit;
- i) Të hartojë dhe t'i propozojë Komitetit Drejtues të FSHK kriteret e përfaqësimit në veprimtaritë ndërkombëtare;
- j) Të hartojë dhe t'i propozojë Komitetit Drejtues listën e sportistëve dhe trajnerëve pjesëmarrës në aktivitetet ndërkombëtare, mbi bazën e kriterëve dhe normave të përfaqësimit në veprimtaritë ndërkombëtare;
- k) Propozon Komitetit Drejtues specialistët të cilët do të dërgohen për seminare kualifikimi pranë organizatave ndërkombëtare të karatesë, kryesisht aty ku FSHK është anëtare;
- l) Të kryejë veprimtarinë kualifikuese për trajnerët dhe sportistët dhe të bëjë kategorizimin e tyre sipas manualit të testimit për breza përcaktuar nga ky komision dhe miratuar nga Komiteti Drejtues i FSHK;
- m) Të përpilojë Rregulloren Teknike të Testimeve për breza në Karate për të gjitha stilet të cilat miratohen nga Komiteti Drejtues i FSHK;
- n) Të përcaktojë listën e instruktorëve, të cilët marrin të drejtën të zhvillojnë testimet për Kyu dhe Dan sipas kriterëve.

Neni 4. Kryetari i Komisionit Teknik, Kompetencat

Kryetari i Komisionit Teknik ngarkohet me kompetencat si vijon:

- a) Të përfaqësojë dhe të mbrojë Komisionin në të gjitha nivelet institucionale;
- b) Të thërrasë dhe drejtojë mbledhjet e Komisionit;

- c) Të përgatisë rendin e ditës për mbledhjet duke përfshirë çështje të propozuara nga anëtarët e saj (ose drejtorët teknikë të shoqatave të tjera);
- d) Të marrë të gjitha masat dhe dispozitat e nevojshme për mbarëvajtjen e mbledhjeve;
- e) T'i propozojë Komitetit Drejtues të FSHK për miratim të gjitha masat që sipas Komisionit Teknik mund të çojë në përmirësimin e sportit të karatesë;
- f) Të informojë Komitetin Drejtues për të gjitha vendimet e miratuara të Komisionit Teknik.

Neni 5. Interpretimi

Komiteti Drejtues i FSHK-së është i autorizuar të japë interpretime autentike të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 6. Shfuqizim

Rregullorja Teknike e FSHK-së, e miratuar me vendimin Nr.1, datë 17.12.2000 "Rregullore e Brendshme e Federatës Shqiptare të Karatesë", shfuqizohet.

Neni 7. Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më menjëherë.

(_____)

(Vula e Federatës)